

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

81H-1  
K 64



PETRAQ KITA

POEZI

Prag feste



### PETRAQ KITA

Ka lindur në fshatin Gostivisht të Kolonjës më 1953. Shkollën 8-vjeçare e ka kryer në qytetin e Korçës. Ka punuar në fabrikën e këpucëve duke vazhduar edhe shkollën e mesme pa shkëputje nga puna. Tani kryen shërbimin ushtarak në radhët e Ushtrisë Popullore.

Ka botuar poezi dhe tregime nëpër organet e shtypit, si në gazetatat «Drita» dhe «Zëri i Rinisë», revistën «Nëntori», etj.

Ky është libri i tij i parë.

854-1

K64

PETRAQ KITA

# PRAG FESTE

Poezi



13008

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

## PRAG FESTE

Sonte

shtëpitë e futura mes dritave si nën limonj të verdhë  
nuk paskan gjumë fare.

Sonte

të dashuruarit mblodhën në park gjelbërimet e  
freskëta të pranverës,  
barin dhe manushaqet

dhe shëtitën më shumë, më larg  
në udhët e bukura të këtyre viteve.

Sonte parqet u mbushën me zëra njerëzish, biseda.

Gjyshi Mina, që femëninë e kaloi nën erërat e  
dimrit, me një bluzë të hollë,

duke mbajtur gurë dhe llaç mbi supet e njoma,

me diellin e pastër të buzëqeshjes në sy,

me kostum të zi e gravatë ngjyrë kafe

shëtit i lumtur rrugëve plot njerëz të dashur.

Sonte

askush nuk fle, —  
as njerëzit  
as qyteti.

Në gjithë madhësinë e kësaj feste të bukur  
zemra ime rreh pranë zemrës së Partisë.

## NË VARRET E DËSHMOREVE

Pllaka të bardha mermeri,  
inicialetë thjeshta,  
të bronxta...

Mbi barin e gjelbër dhe lulet e porsaçelura  
po shkrihet vesa e natës —  
e bardhë,  
e ndritëshme,  
me vezullime të kristalta...

Shkasin nën pllakat e mermerta  
pika vese...  
sikur shkasin mendimet e mia  
të bardha,  
të bardha.

## PAVDEKËSI

Jashtë jeta hidhte hapat e saj.  
Në muret e errëta të qelisë — heshtja,  
mbi dysheme — qepallat e vdekjes  
të përzjera me erën e athët të gjakut.  
Sa netë kaluan kështu vallë?  
Sa herë në hekurat e ndryshkur të qelisë  
trokiti mëngjezi?

Mbrëmjeve kishe dëshirë të bisedoje me shokët.  
mbrëmjeve kishe dëshirë të udhëtoje me shokët.  
të pije me ta një cigare...

Vinte mëngjezi dhe mbulohej nga muzgu,  
vinte muzgu dhe mbulohej nga nata, —  
ditë dhe natë nën tortura...  
Dhe rrije i qetë. Bisedoje me Partinë

e të dukej se ajo ishte aty, në qelinë e ftohtë,  
si një erë e ngrohtë vere...  
Dhe s't'u ulën kurrë sytë!  
Asnjëherë s'mendove për vdekjen.  
E si mund ta mendoje një gjë të tillë... si?

Në dritaren e qelisë cicëronin zogjtë.  
Këngët e tyre s'pushuan as atë mëngjez, kur fashisti  
përplasi derën e qelisë  
dhe mbi trupin tënd mbështeti një sharrë hekuri,  
të vjetër,  
të nxirë.  
Sharra futi dhëmbët e saj në mishin e ngrohtë, —  
ti shtrëngoje dhëmbët në heshtje.

Dhe u mpiks gjaku i kuq, që rodhi në dysheme.  
Kënga jote fërgëllonte nëpër buzë, —  
dhe përpara fytyrës së fashistit të spërkatur nga gjaku  
ti këndove...  
Dhe përpara vdekjes ti këndove...  
Kënga jote ishte një melodi e dridhshme.  
Jashtë hapësira u mbush me zogj të lirë.  
Gjaku yt i pastër mbeti pavdekësi:  
në cicërimat e zogjve,  
në zemrat e njerëzve.



## PËR NJERËZIT DHE MALET

Ne udhëtojmë pranë maleve...

Mbi vetullën e përthyer të Moravës varet një mjegull  
e hollë, e tejdukshme.  
Flokët e borës kanë mbetur mbi degët e drurëve si  
zogj të bardhë.

Ne udhëtojmë pranë maleve...

Malet dinë shumë gjëra për njerëzit, —  
në rrudhat e tyre fshihen rrugët e viteve,  
gjurmët e luftës,  
gjaku dhe plagët  
e mbi to shushurima ujrash të gjelbër plot kristale.

Në këto burime dhe ujvara, që derdhen me zhurmë,  
kështu si ne kanë larë fytyrat bijtë e lirisë  
edhe në dimër,

edhe në verë...

Herë-herë opingat e çara u mbetën honeve të thella  
poshtë shkëmbenjve.

Mbi kurrize të ashpër grykash e malesh  
ka shkelur mishi i butë i trupit të tyre...

Dimri u vishte në këmbë këpucë të akullta,  
pranvera ua shkrinte.

Ndërsa Morava mbante veshur bluzën e dashur të  
lirisë,

bluzën, që u ngjye me gjak,

bluzën, që u mbush me vrima plumbash...

Por njerëzit nuk ndaleshin,

ndonse po derdhej shumë gjak, —  
njerëzit ecnin në male varg.

## N E B O R O V Ë

Në tokën tënde martire, Borovë,  
më solli shpërthimi i sytheve nëpër degë pemësh,  
blerimi i hershëm i tokës,  
i njomë...

Dhe erdha i kapur dorëpërdore me pranverën,  
mespërmes mrekullive të saj...  
mespërmes fshatarëve të dashur babaxhanë,  
nëpër udhët e ngushta fshatarake me shtëpi të  
vogla  
rrethuar me pjergulla e degë mollësh.

Në tokën tënde martire, Borovë,  
më solli shpërthimi i sytheve nëpër degë pemësh,  
blerimi i hershëm i tokës,  
i njomë...

Dhe fjeta si mysafir në shtretër të butë,  
në shtretërit e butë të shtëpive të forta.  
Dhe pashë lule të çelura në luadhin e pranverës,  
dhe pashë njerëz të rinj,  
që kujdeseshin për tokën  
e s'të ndava dot nga zemra, Borovë!

## ËNDËRRIME PRANVERORE...

Tani pemët mbushin degët me lule të bardha.  
Ditët janë të kthjellta dhe zemrat të gëzuara.  
Mbrëmjeve më pëlqen të hap dritaren  
dhe të shkopsit këmishën...  
Në shpirtin tim ecin hapat e njerëzve,  
edhe ata, që i njoha në jetë,  
edhe ata, që s'i kam njohur ende...

Mbrëmjeve ëndërroj me sytë mbi qytetin tim...  
Mbi qytet rrinë zgjuar ëndërrimet pranverore.  
Fqinja ime e bukur i ka mbledhur çarçafët e bardhë,  
që u thanë nën erën e mbrëmjes.  
Ajo fle në shtratin e ëndërrimeve pranverore  
dhe jeton në mëngjeze punëtorësh.  
Ajo shpesh më ka thënë se netëve ëndërro  
udhë të gjata... të gjata kantjeresh.

Sa herë vjen pranvera  
ndjej në shpirt një shqetësim të dashur:  
ëndërrimet rinore...  
Në ndjenjat e mia lëvizin njerëz  
bashkë me qytetin,  
lëvizin turma punëtorësh,  
qyteza industriale,  
fëmijë të vegjël që vrapojnë rrugëve.  
Lëviz komunistja e vjetër Mallama Samaraj,  
që i fali dy djem luftës,  
dy djem të bukur... azganë!  
Lëvizin bredhat e gjelbër të parkut.  
Lëviz mjeshtri i vjetër i ndërtimit  
Vangjel Todorovi...

Eh, ëndërrime të lumtura pranverore!  
Gjithmonë i dashuruar dua të jem pas jush,  
qofshin të gjitha ëndrrat e mia  
përherë në udhë... në udhë...

Tani pemët mbushin degët me lule të bardha.  
Netët janë të kthjellta dhe zemrat të gëzuara.  
Mbrëmjeve më pëlqen të hap dritaren  
dhe të shkopsit këmishën...  
Fle qyteti im i dashur.  
Flenë njerëzit,

fle dhe fqinja ime e bukur.  
Natën e mirë!  
Natën e mirë!  
Gjithë njerëzve të dashur,  
gjithë njerëzve punëtorë...  
Nesër përsëri do të rrugëtojmë kantjereve,  
nesër përsëri do të ëndërrojmë... përsëri...  
Natën e mirë!

## ME BARINJTË NË KULLOTAT VERORE

Unë erdha ashtu thjesht te ju,  
Një mbrëmje të qetë vere...  
Në vargun e parë të vjershës (ashtu si në një  
lirikë dashurie)  
përfytyroja hënën e bardhë si qumështi,  
barin e gjelbër si shalli i një studenteje,  
bariun e dashur si gjithë njerëzit punëtorë,  
qingjat e vegjël...  
dhe delet  
si statuja të bardha në muzg.

Bariu Mellan mbante një qengj në dorë  
me lëkurë të bardhë e pulla të zeza,  
dikush ia qante fyellit lehtë e lehtë,  
një tjetër vërshëllente motive të lira.

E drodhëm një duhan të fortë me fletë  
dhe filluam një bisedë të thjeshtë për delet.

Bariu Mellan më thoshte:

— Me qumësht të freskët do t'ua lajmë buzët  
fëmijëve,

me qumështin e ngrohtë të deleve...

Dhe do të marrim më shumë qingja se vitet e  
tjera

sepse...

për këtë punë u mbledh organizata

dhe folëm të gjithë në emër të ndërgjegjes.

Ndaj i duam kaq shumë qingjat,

ndaj i duam kaq shumë delet,

që i përkëdhelim ashtu si fëmijët

tanë buzëmbremjeve të buta.

Dhe i qeshën sytë bariut Mellan...



## NË KËTO VISE

Në këto vise fryjnë erëra të ftohta.  
Diku njerëzit e kanë zhyeshur tokën nga kaçubet dhe  
barërat,  
ndërtuesit kanë ngritur qytezat.  
Zogjtë të trembur nga zhurma shtegtuan që në  
pranverë.  
Në këto vise çdo ditë shkruhen reportazhe,  
merren intervista,  
vijne dhe piktorët për tabllo dhe skica.

Në këto vise erdha dhe unë një mëngjez,  
dhe njoha një ndërtues të vjetër...  
Ka tridhjetë vjet që gatuan beton,  
ka tridhjetë vjet që shtegton qyteteve, kantjereve...  
Njerëzit duke hapur dritat e dhomave të qeta  
mbrëmjeve,  
kanë ndriçuar fytyrën e tij...

Në muret e bardhë apo në pezulet e dritareve  
kanë ndjerë djersën e tij...  
Duke ngjitur shkallët e hekurta të korpuseve  
industriale  
kanë ndjerë hapat e tij...

Unë njoha njeriun, që në lumturinë e njerëzve  
i çel të gjitha dashuritë...



## KËNGË E RE PËR NJË MOTIV TE VJETER

Është stina kur kopshtet dhe udhët bien erë mollë,  
erë dardhë,  
koha kur rrushi është pjekur në pjergulla,  
koha kur ftonjtë zverdhojnë.

Në kasollen e vogël të rojtarit hyj unë.  
Janë ditë të freskëta,  
është vjeshtë...  
Duke dashur të më thotë diçka për vitet  
rojtari babaxhan tregon:

«Te kjo fushë e madhe, e gjerë,  
ku nata ka ulur buzët e buta,  
nëpër botën e thellë të ngjyrave  
mes mollëve,  
dardhave...

dikur pushonte një kënetë.  
Ktheheshin natën vonë peshkatarët  
me pesë peshq në trastë.  
Kur sëmurej peshkatar i varfër  
fëmija vështronte kënetën...  
Ja, atje kishte shumë peshq,  
që babai i sillte natën,  
kishte mushkonja, ujë të vjetër, llum,  
ajër të rëndë dhe erë të keqe, —  
sëmundje atje kishte aq shumë  
sa peshq nën kallamat e blertë...»  
Ne flasim në kasollen e vogël,  
në kashtën e butë, ku gjumi lehtë të merr  
dhe vjen era mollë,  
dhe vjen era gjeth.  
Është stina kur kopshtet dhe udhët bien erë mollë,  
erë djersë...  
Është koha kur në tokën e dashurive tona  
çelin filizat e stinës së Partisë!

## SA PËR NJOHJE

Kur linda...  
thitha ajrin e korijs mbushur me drurë  
dhe m'u zgjeruan mushkëritë si hapësirat e maleve;  
piva qumështin e bardhë të nënës  
dhe u bëra i shëndetshëm dhe i fortë;  
piva ujin e kthjelltë të burimeve  
dhe u bëra i çiltër dhe i singertë;  
ndoqa pyjeve lepuj e thëllëza  
dhe m'u bënë gjymtyrët të shpejta si të drerëve...  
Dhe pashë se bota ishte shumë e madhe  
e mbushur me njerëz,  
e mbushur me ngjarje!

Kur linda unë...  
edhe në majat më të larta të maleve,  
njerëzit kishin shkruar kapituj nga dashuritë e tyre:  
fjalët PARTI-POPULL-ENVER.

## PO IKI KËTË MËNGJEZ VJESHTË

Po iki këtë mëngjez vjeshte...

Në dyqanin e vogël buzë rrugës, dëgjohet zhurma e  
ekspressit  
dhe kafet e porsabëra lëshojnë avullin e ngrohtë.

Po iki këtë mëngjez vjeshte...

Ja dora e nënës me shaminë e bardhë,  
ja dora e ashpër e babait...

Motra ime Eridili nuk duket më  
dhe as duart e vogla të Romeos,

vëllait që desha më shumë.  
Një turmë e madhe njerëzish, si një familje e madhe,  
dy-tri shtëpi,  
drurë...

dhe përpara rrugë.

Po iki këtë mëngjez vjeshte...

Udhëtar i udhëve, ku shkuan të gjitha pranverat e  
viteve të mi.

Jemi të gjithë 19 vjeçarë, atdhe!  
Më tepër se kurrë tani e ndjejmë... e ndjejmë  
se jemi bijt' e tu...  
Jemi djem vërtetë!

## SHQETËSIM

*«Dje unë nuk dola mirë në qitje  
dhe gjithë natën mbeta i shqetësuar...»*

*(nga një dialog)*

Të kam kaq pranë vetes...

Gishtërinjtë e mi shkasin mbi metalin tënd të ngrohtë,  
era grindet nëpër drurë,

bari i luginës dridhet gjithë shushurimë...

në thellësinë e shpirtit tim dridhet shiu i mendimeve.

Nata u tret bashkë me hënën e bardhë

dhe drita e mëngjezit puthi fijet e barit, —

nuk e di sa orë mbeta i shqetësuar si era

me gishtrinjtë e duarve në metalin tënd të ngrohtë,

nuk e di sa kohë fola me veten time nëpër qetësinë e  
natës

dhe m'u duk se flisja me shokët...

M'u duk sikur fijet e barit treteshin në ajrin e

mëngjezit

ndërsa në thellësinë e shpirtit tim dridhej e dridhej

shiu i mendimeve.



## NE GOSTIVISHT

Eci rrugëve fshatarake,  
rrugëve të vendlindjes sime.  
Në shportat e syve mbledh gjithshka të pastër:  
lëndinat, ku kam bredhur,  
malin e Tringullit, ku mblidhja bedunica,  
gjyshin Mina, me cigaren e trashë në gojë, ulur  
në sofatin e gurtë,  
një shtëpi të madhe me oborr dhe çatinë e murrme  
veshur me dërrasa.  
një kopësht të vogël, një fik, kaçkë dhe tri-katër  
pjergulla...

Në kurrizin e bardhë të një kali të bukur  
dhe mbi degët e drurëve  
ka mbështetur trupin e butë fëminia ime.

Dhe e ndjej: çdo hap — një emocion,  
çdo tingull zëri — një dashuri e madhe...  
Gjethet pikojnë vesë,  
zemra pikon mallin.

## ELEGJI PËR PARO KITAN...

Vareshin qershitë nëpër dëgë,  
era e fiqve kundërmonte kopshteve. —  
një nënë shqiptare,  
andartët grekë vranë një buzëmbremje.

Në kishën e vogël të Shën Thanasit  
qershitë lëshuan një lëng të thartë, të hidhur.  
Në buzët e njerëzve u tha pështyma  
dhe urrejtja u mbledh si lëmsh në grykë.

«Jam nënë shqiptare — tha Paro Kita —  
dhe shqiptarizmin ju s'mund ta vrisni...»  
Në fytyrat e nënave kolonjare,  
shkisnin lotë si grushte të tendosur.

Dhe humbi fshati i vogël Gostivisht atë natë  
patrioten Paro, nënën trime...

Ndërsa natën filloi ta griste një mëngjez i bardhë  
dhe mbi drurë rrëshqiste një diell.

Sa herë varen qershitë nëpër degë  
dhe era e fiqve kundërmon kopshteve,  
nga korijet e bukura zbret jehona e një zëri,  
që thyen copë-copë qelqet e kishave nëpër dritaret:  
Jam nënë shqiptare!

## MËNGJEZ NË FSHAT

Mugëtira humbi në korijen e madhe.  
Mbi gjethet ra drita si trëndafili i bardhë.  
Tringëllima këmborësh valëzohen udhëve,  
mozaikë qingjash dhe barinj...

Të urtat, të dashurat gjyshet e mira  
pregatisin në tundjet dhallën e ëmbël;  
vajzat e vogla i hapën dritaret  
dhe i ngjyen përparëset në ujin e diellit.

Vesa pikon mbi barin e gjelbër  
dhe shkrihet si ëmbëlsia e një tregimi lirik.  
Nëpër degë drurësh fëshfërijnë zogjtë,  
fëshfërijnë këngët e tyre... fëshfërijnë.

Në fushat, ku dielli ka ulur rrezet,  
fshatarët kanë dalë me kohë;  
nga korijet fluturojnë turma harabelash,  
fluturojnë, fluturojnë...

## NET TË ARTA

Me gjyshin Mina udhës së fshatit  
kthehesha një mbrëmje të qetë vjeshte, —  
vinte era grurë i pjekur,  
vinte era mollë starkinge...

Hëna mbeti në natën e artë  
me fytyrën mbështetur mbi barin e mullarëve, —  
ari i natyrës dhe ari i njerëzve  
në vallen e heshtur të ndjenjave luante.

## NJË VJERSHË E SHKRUAR NËN SHIUN E ARTE

- Eja nën shiun e artë! — më thoshin fshatarët.
- Eja nën shiun e artë! — më thoshin autokombajnat e zhurmëshme.
- Eja nën shiun e artë! — më thoshin erërat e buta me zërat e tyre.
- Eja nën pistën e stinës së artë! — më thoshin këngët e fëmijve.

Gjithë natën punuam nën hënën e bardhë,  
nën shiun e artë të vjeshtës...

Gjithë natën ndjemë zhurmën e qerreve, trakto-  
rëve

dhe buzëqeshjen e zëtoristes Luljetë!  
Dhe...

kur mëngjezi trokiti në portën e natës,  
m'u mbyllën qepallat  
dhe fjeta pranë një mullari me bar.



Në ëmbëlsinë e gjumit, m'u duk sikur në mollzat e  
faqeve

fërkoheshin kallëza gruri  
si duart e buta, të ngrohta të nënës sime...  
dhe flija shumë i qetë,  
dhe isha më i lumturi.

Përherë në ëndërr le të shoh kallëza gruri!

## TREGIM PËR NJË SHOK

Ai vjen çdo ditë në kantjerin tonë  
nga fshati i largët me shtëpi prej guri.  
Në vjeshtë kur fillojnë e piqen ftonjtë  
ne flasim për jonxhën,  
tërfillin,  
grurin.

Ai vjen nga fshati i largët me shtëpi prej guri  
dhe bashkë montojmë turbinat e hekurta,  
ngjitemi dhe zbresim nëpër skela.

Një mbrëmje, tek rrinim nën hijen e një mani  
dhe flisnim për punët e kantjerit,  
na foli për një vajzë të thjeshtë,  
vizioni i së cilës e ndiqte nga pas  
në rrugë,  
në shtëpi,  
në kantjer.

Dhe erdhi vjeshta në kantjerin tonë.  
Ai vinte nga fshati me shtëpi prej guri, —  
me vehte sillte shpesh ftonj të verdhë  
dhe biseda për jonxhën,  
tërfilin,  
grurin.

Një mëngjez na solli ftesat për dasmën e tij.  
Dhe u nisëm të gjithë sëbashku  
në fshatin e shtëpive prej guri.

## IKËN PELIKANËT

Ikën pelikanët në mbrëmjen e qetë.  
Fijet e shavarit u drodhën lehtë  
si dridhet melodia në telat e një violine...

Përse ikën pelikanët mbrëmë?..

### 2

Pelikanët ikën dhe erdhën traktoristët, —  
ndërsa hëna rrinte e trishtuar mbi fijet e  
shavarit.

Në netët e gjata fëmijët ëndërronin  
luadhin e verdhë të pafund të grurit...

Po ktheheshin moçalet në toka buke...  
Njerëzit grumbullonin shavarin e lashtë,

sikur i hiqnin tokës copëza legjendash  
të vjetra, të lëna si plagë.

3

Kur të vijnë ndonjë mbrëmje tjetër pelikanët  
hëna do të jetë ulur mes grunjërave...

## NË MUZEUM

Stenda të mbushura me letra të zverdhura nga  
koha,

një revolver,  
faqe gazetash,  
demostrata,  
zëra të largët,  
zëra të afërm, —  
gjithçka e paharruar,  
e futur brenda në rekuizitën e pavdekshme të  
muzeut,  
e futur brenda në faqet e historisë,  
e futur brenda në zemrat tona.

**BASHKATDHETARËVE TË MI TË MBETUR  
NË MATHAUZEN**

Shumë larg ju çuan, bashkatdhetarë të mi...  
Ikët duke mbajtur në zemër tokën shqiptare.  
Dikush nga ju harroi të mirrte me vete xhaketën,  
një tjetër këpucët i veshi pa lidhëse...  
Djemtë i lanë këmishat e verës,  
të lara e të varura nën erën e mbrëmjes.

Më pranë tokës fërkohej bari...  
bari flinte në krevatin e tokës;  
në Mat'hauzen më pranë njerëzve ishte vdekja...  
vdekja flinte me njerëzit.  
Ju nuk u kthyet më të kërkonit këmishët e lara në  
degët e pemëve, —  
shiu i luftës i lagu dhe i mori me vete...  
Po unë ndjej pranë vetes edhe zërin tuaj,  
o bashkatdhetarë të mi...

Ndaj kur vjen 5 Maji në tufat e luleve  
kam edhe lulet për ju,  
në mallin dhe dashurinë e njëzet e tetë mijëve  
kam dhimbjen për ju...

Ndaj u them gjith' zogjve, që fluturojnë hapësi-  
rave,

të ndalen në tokën ku mbetët ju  
dhe t'ju thonë se nuk ju harrojmë...  
dhe t'ju thonë se malli na ka marrë shumë.



\* \*

Në qytetin e vogël buzë liqenit  
gjithë natën ra borë.  
Në mëngjez qyteti i vogël buzë liqenit  
lëvizte qerpikët e bardhë.

Pranë kallamishteve fëshfërinin gujzat<sup>1)</sup>  
dhe banorët e shëndetshëm pastronin rrugët.  
Në varrezat e dëshmorëve kurorat e luleve  
u mbushën me pluhur të bardhë...

Gjatë gjithë stinës do të bjerë borë,  
shkopinj akulli do të varen nëpër degët e drurëve,

---

1) zogj që e kalojnë dimrin në brigjet e liqenjve.

në liqen do të ndihet kënga e gujzave,  
kënga e zogjve dimërorë...

Gjatë gjithë stinës kjo borë e butë  
do të mbajë ngrohtë kurorat e luleve,  
që të mos vyshken  
ashtu siç mban edhe farën e grurit  
të mbjellë në një fund vjeshte.

Në pranverë ujrat e borës do të shkrijnë  
dhe do të lajnë gonxhet e kurorave të luleve.

## E PAHARRUARA...

Në një tavolinë, pranë luleve, një plak rëkëllente një  
gotë birrë...

Radio Tirana jepte këngën «Vajza e malevë»  
«Flokë ngjyrë ari kish ajo,  
sytë të mëdhenj edhe të zes...»

Plaku uli gotën mbi tavolinë  
dhe vështrimin e treti diku, mes gjetheve.  
Në faqet e rrudhura i pikuan lotë të nxehtë.  
Mbas pak tingujt e këngës u shuan.  
Dhe u duk se «Vajza e maleve» u zhduk mes drurëve.  
Plaku puliti sytë,  
lëvizti qepallat...  
«Eh, o djem — na tha — ju s'e keni njohur parti-  
zanen Ofeli,  
ju s'e keni parë si qëllonte mbi armiqtë,  
ishte e dashur si në këngë,

ishte trimëreshë si në këngë,  
ishte gojëmbël si në këngë,  
ishte e pavdekshme si në këngë».

Kur dolëm nga lulishtja  
nëpër rrugë shushurinin gjethet e pemëve.  
Nga malet përballë zbriste një pui.

Ne ecrim dhe mendonim,  
Dhe nuk mund ta harronim kurrë plakun  
dhe partizanen Ofeli!

## KY MËNGJEZ LAMTUMIRE...

Kortezhi i njerëzve kalon këtë mëngjez  
ngadalë nëpër portat e hapura të qytetit.  
Në heshtjen e njerëzve ka dhembje  
për një partizan të vjetër...

Oh, ky mëngjez lamtumire,  
ky mëngjez i mbushur me bisqe të freskët  
të spërkatur me vesën e natës.  
Në arkivolin e kuq të mbushur me lule  
fle përjetësisht partizani Riza Kodheli.  
Dielli si kurorë e artë mbi ngjyrën e kuqe të tokës  
ulet.  
Nga dyert e shtëpive dalin njerëz  
dhe kortezhi në rrugë zgjatet, zgjatet...

Lamtumirë, partizani Riza Kodheli!  
Mbi arkivolin tënd nga një grusht me dhe hedhim...

Dhe zogjtë, që lëvizin nëpër gjethe  
dhe bari, që dridhet  
dhe njerëzit  
jetojnë këtë mëngjez të bardhë lamtumire...

Po kthehemi rrugëve të Korçës pa ty.  
Nëpër mëngjezin e mbushur me zhurmat e kohës  
të lamë në trupin e ngrohtë të tokës.  
po pranë të kemi përjetësisht!

## NË LAGJEN E NJË QYTETI BREGDETAR

Në lagjen e një qyteti bregdetar të lagur nga erërat,  
një buzëmbremje kishte shumë njerëz.

Shëtisnin nën degët e rënda, si krahët e një shpendi  
të madh, të palmave;

uleshin nëpër stola...

Mbi barin e gjelbër të tokës, nëpër lulishte ose buzë  
bulevardit

kishte shumë skulptura:

burra të hijshëm, me vështrim të rreptë, të mbetur  
në udhët e luftës së Vlorës,

djem buzagas, që i buzëqeshnin lindjes së diellit,  
vajza mbi piedestale, të mbetura në një nga kështje-

llat e luftrave të përgjakshme,  
fëmijë të vegjël, të bukur,

që dukej sikur kishin qëndruar pezull mbi pedestal.

Njerëzit, që shëtisnin në këtë qytet bregdetar,

i kanë lindur skulpturat nga zemrat.

Çdo natë skulpturat flasin me detin,

çdo natë skulpturat flasin me njerëzit!

## R U D I N A

Rudina erdhi në kantjerin tonë  
një mëngjez prilli, kur çelnin lulet e mollës, —  
me shtat të vogël,  
syzezë  
dhe me flokët gështenjë  
ajo mpleksi mendimet dhe rrudhat e tokës.

Duart e saj kapën levat e hekurta  
dhe lëvizën traktorin nëpër tokën e madhe.  
U drodh toka...  
U drodhën lulet e mollës  
dhe ranë mbi traktorin si flutura të bardha.

Pas pune Rudina mblodhi petalet e rëna  
dhe qeshi...  
Dhe rendi e lehtë nëpër plisa, —  
mes freskisë së avujve,  
e dashuruar.



## KA ARDHUR VJESHTA

Ka ditë që në qytetin tim ka ardhur vjeshta.  
Në akuarielet e piktorëve drurët u zhveshën,  
udhët u mbushën me gjethe të verdha;  
në stolat e parkut dridhet shalli i ftohtë i erës.

Ka ditë që në qytetin tim ka ardhur vjeshta.  
Ka ditë që shkollat u mbushën me gjimnazistë,  
në kantjerin buzë qytetit betonohen shtylla...  
Redaktori i gazetës «PËRPARA» punon mbi një  
reportazh nga fushat,  
Mimoza, punëtorja më e re e kombinatit të triko-  
tazheve,  
ëndërron bluza të bukura për vajzat e lumtura...

Ka ditë që në qytetin tim ka ardhur vjeshta,  
ka ditë që frutat janë pjekur dhe fshatarët po  
mbushin koshat.

nuk ka gjë se drurët janë zhveshur,  
nuk ka gjë se udhët janë mbushur me gjethë të  
verdha.  
Fëmijët, me fytyrat e bukura mbështetur në  
xhamat e dritareve,  
përfytyrojnë rrugë të bardha...

## PËRSERI NË RRUGË

Dy herë erdhi pranvera...  
Dhe ne i lamë fytyrat në ujrat e kthjellëta të saj,  
kryqëzuam vështrimin përmes luleve të mollës,  
që çeli pranë kantjerit.

Në fillim ditët tona të zhurmshme  
sollën kazma, dërrasa, gurë...

Dy herë erdhi vera...  
Dhe ne u puthëm me diellin buzë më buzë,  
nga dritaret e hapura të pallatit.  
Rritja jonë fillonte nga dëshira për t'u ngjitur  
lart,  
vetëm lart,  
sikur udhëtonim për në shtëpinë e diellit.

Dy herë erdhi vjeshta...  
Dhe nga lartësitë e kateve ne shikonim  
garën e heshtur të kalimtarëve me gjethet në  
rrugë.

Dy herë erdhi dimri...  
Dhe mbi dritaret dhe taracën e pallatit të ri  
u ul një borë e bardhë, e butë  
si sfungjer deti...

Sa herë u ndrruan stinët kështu?  
Tani ne i prishëm barakat e vogla.  
Morëm me vete veglat e punës  
dhe ngarkuam në maqinë epikën e fundit të një  
kënge industriale...  
E lamë pallatin e bukur ku do të banojnë njerëz  
të lumtur  
dhe dolëm përsëri në rrugë...

## PASHË LOPËT TEK KULLOSNIN...

1

Pashë lopët tek kullosnin  
në relievin e thyer përballë maleve.  
Në fijet e barit që ato përtypnin,  
në trastën e hapur të bariut,  
ku gruaja kishte vendosur një pjesë të dashurisë,  
në çatitë e vogla të shtëpive të fshatit,  
në vetullat e dëndura të maleve, —  
në gjithshka që rritej në tokën time  
kishte diell.

2

Toka ime me diell!

Jeta ime me diell!

Zemra njerëzish me diell!

Në mbrëmje lopët u kthyen në fshat...  
Në mbrëmje mjelset e bukura morën kovat ngjyrë  
dielli  
dhe i mbushën me qumështin e bardhë.

## PA TITULL

Në zemrën e Uollt Uitmanit  
fëshfërinin çdo natë fije bari...  
Bari ishte fëmija i tokës,  
toka jo e të gjithë njerëzve.

Në zemrën e poetit ëndrrat e jetës  
rriteshin si fëmijë të vuajtur.

Në zemrat e fshatarëve tanë,  
që kthehen sonte nga fushat e gjëra,  
çdo natë fëshfërijnë këngët e tokës.  
Mbi supet e tyre varen shportat me mollë,  
që kuqëlojnë.  
Mollët janë vajzat e pemëve,

pemët fëmijët e tokës,  
toka e të gjithë fshatarëve.

Në zemrat e fshatarëve tanë ëndrrat e jetës  
rriten si fëmijë të lumtur.



## PLANTACIONE HALLESH

Në netët e nxehta të verës  
palmat buzë detit varen në tokë si çadra plazhi.  
Pranë palmave mblidhen negërit  
dhe shkundin lotët bashkë me pluhurin e ditës,  
lotët me ëndrrat e ndrydhura të jetës...  
Negërit janë njerëz si gjithë të tjerët,  
që dinë të shëtisin në liqen në netët me hënë,  
nëpër lulet e njoma buzë drurëve të kafenjtë,  
që njohin pranverën e ulur mbi lulet e kajsisë  
dhe bukurinë mahnitëse të netëve të Majit.  
Mbrëmjeve negërit mblidhen nën poemat buzë  
detit,

negërit afrikanë...

Në pëshpëritjet e tyre ka plantacione hallesh  
të përzjera me erën e njohur të kafesë  
dhe qumështin e bardhë e të hidhur të bambuve.  
Në agimet e ditëve a netëve vonë  
negërit nuk dinë të heshtin.

## S O L I D A R E . . .

Ka kohë që jam i shqetësuar netëve,  
kur mendoj se shumë njerëz në botë dremisin  
rrugëve

pa strehë,  
nën shi  
dhe erë...

Në timpanin e veshit më buçasin emra qytetesh —  
Tokio, Londër, Nju Jork, Nagasaki, Mançester.  
E si të mos shqetësohem unë poeti,  
kur shoh se në botë ka njerëz maskarenj,  
që strehojnë në dhoma të ngrohta e të rehatëshme  
raca të ndryshme qensh  
ndërsa njerëzit e ndershëm,  
njerëzit punëtorë,  
dremisin rrugëve pa strehë,  
nën shi  
dhe erë?!

Ka kohë që jam i shqetësuar ditëve...  
Dal rrugëve të qytetit dhe përshëndes e më  
përshëndesin njerëz të gëzuar,  
kaloj mes punëtorëve portën e fabrikës  
dhe prodhoj për njerëzit këpucë të bukura e të  
forta,  
shfletoj dispenca e revista,  
flas me shokët e mi për komunizmin,  
për programet televizive, mbi ngjarjet nëpër botë,  
për njerëzit, që kërkojnë diellin e përgjakur  
të futur midis barikadave të  
mjegullta të barutit.

Ka kohë që jam i shqetësuar,  
ka kohë që pastërtinë e shpirtit ua kam falur gjithë  
proletarëve revolucionarë të botës, —  
le të bjerë mendimi i vargut tim mbi këmbanën e  
komunizmit  
pareshtur...  
Solidar!

## DIÇKA PËR BAJRONIN

Fryu era dhe rrëzoi gjethet e kumbullës.  
Ato u shpërndanë si zogj pendëgjelbër gjithkund,  
humbën...

Era më shfletoi dhe mua faqet e «ÇAJLD-  
-HAROLD-it»,  
dhe pa dashur librin ma mori një rrjedhë lumi:  
mes valëve vargjet dhe gjethet bashkë po iknin  
e mbas pak gjithshka humbi si pas një ëndërrimi.

S'do t'i gjejnë kurrë njerëzit ato gjethe kumbulle  
që era i shpërndau si zogj pendëgjelbër  
gjithkund, —  
po vargjet e Bajronit në «ÇAJLD HAROLD»  
dallga s'do t'i tretë,  
dallga s'do t'i humbë...

POETËVE QË E QUAJNË VETEN «MODERNE»

Tani lulëzojnë pemët dhe ju mund t'i imitoni ato.  
S'është çudi që mund të bëheni gaforre,

luspa deti,  
mund të bëheni leshterikë të rrudhur në ujrat e jetës  
dhe, pa e ditur as vetë, zogj që ngrohni vezët e dimrit.

Ju mund të bëheni ekuacion i pazgjidhshëm  
për atë që kthehet nga kantieri dhe duart i ka me  
thërmiza betoni...

Mund të mblidhni dhe shtrembëroni buzët  
kur punëtorët duke lexuar vjershat tuaja do të  
ngrejné supet  
dhe do të thonë: «Ç'janë këta që na lodhin trurin»...  
Nuk është koha të hipni mbi portokalle dhe të shihni  
globin,  
nuk është koha të lodheni duke ndjekur me sy  
merimangën,

që vërtitet rreth tavanit të dhomës...

Duhet të lodheni, të djersini për poezinë e vërtetë.

Ajo është atje ku e pashë unë dje,

në vullnetin e hekurt të një vajze fshatare,

që i mëshonte parmendës në tokën e madhe,

në sytë e qeshur të saj...

## M B R È M E

Mbrëmë fshatari Zeqo na fliste për grunjat,  
që si gjerdhanë floriri vareshin në fushë,  
mbrëmë vajza Eli me sy të kaltër  
kaltërsinë desh ta ngjyente me ngjyrën e verdhë.

Kur perëndoi dielli ne zgjatëm duart  
si të donim të rrëmbenim horizontin e kuq  
e ta fusnim në fushë, mes grunjërave,  
dhe t'i ngjyenim tok në muzg.

Mbrëmë qëndruam shumë në fushën e artë.  
Thurrëm ëndrra të kaltra, të kuqe, të bardha.  
Mbrëmë era e bukës na dehu  
e na u duk se ndodheshim në një luadh me ngjyra.

## PEJZASH INDUSTRIAL

Fluturuan zogjtë tej horizontit mes maleve,  
ikën dhe brumbujt e ngathët;  
ndonjë gjarpër a nëpërkë u fsheh buzë ahishteve  
dhe fusha mbeti e qetë si skulpturë e bronxët...

Bari u zhduk papritur si një ëndërr e vogël  
dhe u përzie me dheun e verdhë të fushës;  
insektet e trembura nga zhurma e traktorëve  
zukatnin, vërtiteshin e s'gjenin dot rrugën.

Shtyllat e betonuara ngritën kokat e tyre lart  
sikur i jepnin biografinë qiellit të pastër kurioz,  
plot energji gjuhët e rënda lëviznin vinçat  
e mbartnin agregate, hekura, mendime plot.



## SHI NË MAJ

Si nisi kështu papritur këtë mbasdite shiu!  
Strehët e çative u mbushën me njerëz:  
me pleq,  
punëtorë,  
nxënës, —  
nën një strehë dhe ne të dy.

Ti qeshe dhe unë e harrova fare shiun  
e të tërhoqa për dore në rrugën e madhe,  
në rrugën me njerëz të dashur...  
Shiu na qulli flokët,  
fytyrën, bluzat pranverore...  
Shiu shushurinte nëpër gjethet e pemëve.

Dhe m'u duke më e bukur  
me flokët e shpupurisura  
të lagura nën shi.

## K O R Ç Ë S

Konturet e tua i largova nga imazhet e poetëve.  
nga fantazitë e tyre.  
deklamimet.

Ty,  
të ndjej në çdo regëtimë zemre, —  
te ti dhe ajri është ndryshe.  
dhe uji,  
dhe toka,  
dhe lulet.

Kur jam larg teje  
konturet e tua,  
njerëzit,  
parqet...  
i ndjej thellë në shpirt.

## D I M È R

Qielli derdh pareshtur flokë bore  
si mijra pendë pulëbardhash, —  
Zbardhëllohen drurët, ndërtesat, njerëzit...

Qielli ngado derdh flokë bore  
e na duket se gjithkund kanë rënë zambakë të  
bardhë  
nga ata që vajzat u çojnë të dashurve.

## LIRIKA E DITËVE TË BARDHA...

Erdhi dimri dhe bora mbushi degët e drurëve.  
Pullazet e shtëpive vunë kapele të bardha.  
Shitëset e frutave i mbushën vitrinat  
me mollë dimërore  
dhe hurma.

Fëmijët mbajnë në duar topa bore si zambakë të  
bardhë.

Fëmijët, që e duan aq shumë dimrin,  
na gjuajnë me topa bore  
në mëngjez, kur dalim nga shtëpia për në fabrikë,  
(vajzat më tepër se djemtë),  
në mbrëmje kur shëtisim në bulevardin «LENIN»,  
(vajzat më tepër se djemtë).

Dhe shpërndahet bora e butë nëpër flokët e  
vajzave.

Çdo ditë, nga e njëjta rrugicë, për në fabrikë  
mes punëtorëve nxitojmë edhe ne të dy.  
Ajo ka flokë të butë, të ndritshëm  
dhe i pëlqejnë shumë ditët e bardha  
ashtu siç i pëlqejnë trëndafilat me vesë të Majit.

Erdhi dimri dhe bora mbushi degët e drurëve:  
Pullazet e shtëpive vunë kapele të bardha.

Ne të dy punojmë në fabrikë,  
përherë mes punëtorëve...  
Bëjmë këpucë të bukura,  
të forta,  
të lehta,  
për dashuritë e njerëzve ditëve të bardha.

Në sytë e së dashurës lirikat e një stine  
i shoh mes punëtorëve si edhe të mijat!

## KËMBANA ME TINGUJ EPIKË

Në bedenën më të lartë të kështjellës  
varet një këmbanë e heshtur...  
e madhe  
dhe e rëndë.

Me atë këmbanë zgjoheshin arbërit e kështjellës,  
me atë këmbanë fillonin luftrat...  
Malësori që i binte nuk ishte prift mesjetar  
me veladon  
dhe mjekër të gjatë e të bardhë...  
Ishte një kështjellar, si gjithë malësorët,  
me gjoksin zbërthyer,  
ku vallzonin erërat dhe tretej bora e dimrit;  
ishte një kështjellar që në mbrëmje, pas luftës,  
mund ta mbante zemrën e gjakosur në pëllëmbë të  
dorës  
dhe të mos i hapte më qepallat...  
e prapë buzëqeshja t'i mbetej e freskët në buzë.

Të nesërmen një malësor tjetër i binte këmbanës  
në kështjellën e madhe rrëzë maleve hijerëndë...  
Zgjoheshin arbërit;  
niseshin në betejat e luftës,  
dhe dridheshin turqit çallmëverdhtë.

Në bedenën më të lartë të kështjellës  
varet një këmbanë e heshtur...  
e madhe  
dhe e rëndë.  
Askush nuk mund të thotë se duke ardhur këtu,  
s'dëgjon tinguj të zjarrtë epikë.

Porta e Kështjellës, Krujë.

Maj — 1973

## NË SHËRBIM

Flenë shokët e mi të dashur  
fle një pjesë e trupit tënd, atdhe;  
jasht ka hënë të bukur,  
jasht s'lëviz asnjë gjeth.

Troket zemra ime në qetësinë e natës,  
pranë frymëmarjes së lirë të ushtarëve.  
Dhe po të ndodhë që qepallat të më mbyllen  
ndonjëherë,  
dy milion zemra trokasin mbi mua...  
Dy milion zemra më mbajnë zgjuar përherë!



## NJË NATË FUSHIMI

Ra bora e parë...

Fjollat e saj u shuan me një psherëtimë

të mbytur

në grykat e nxehta të topave.

Tani deti shtyn valët në bregun e

veshur me fiçorë të bardhë.

Mbi çadrat mbështet gishtat e butë muzgu,  
mbi çadra bie borë...

Në një çadër të vogël, si shtëpi e bardhë,  
telegrafisti njofton komandën eprorë  
se në qitjet luftarake dolëm faqebardhë.

Vonë, kur deti është i qetë  
dhe bora e ka ndalur frymën e saj,  
dëgjohet kënga e një fisarmoniçisti  
për tanket,  
detin,  
pulëbardhat  
dhe ushtarët.

## SËRISH ERDHA...

Sërish erdha në qytetin tim  
në jugun e ftohtë, por të bukur.  
Kapotë të murrme mbaj veshur tani  
e n'kapelen e gjelbër yllin...

Eci nëpër asfaltin e hirtë të bulevardit  
ku në pranverë çelin aq shumë gështenja, —  
mbrëmjeve shpesh jam kthyer andej  
i ngarkuar me motive vjershash...

Në rrugë shoh njerëz, i përshëndes  
dhe marr prej tyre vështrime të dashura.  
Po ku është vajza e bukur e furrtares,  
që më buzëqeshte tek porta?..

Ku janë fëmijët e vegjël, ku janë?  
Ata që gjithë ditën merreshin me pëllumba

tani janë rritur, mësojnë ABC-në  
dhe s'kthehen më vonë nga lodrat.

Vajza e furrtares është bërë studente,  
me shokë dhe shoqe studjon inxhinerinë.  
Gjithë rrugët e qytetit më çojnë kantjereve  
tek shokët e mi punëtorë...

Sërish erdha në qytetin tim  
në jugun e ftohtë, por të bukur.  
Kapotë të murrme mbaj veshur tani  
dhe në shpirt dashurinë për njerëzit...

## NËPËR RRUGËN E GJELBER

Ka disa ditë që e bëjmë këtë rrugë:  
Vlorë-Uji i Ftohtë — Sektori i parë.

Në të gjitha bisedat tona  
lëkunden degë me mandarina e portokalle.

Ka disa ditë që e bëjmë këtë rrugë:  
Vlorë — Uji i Ftohtë — Sektori i parë.

Në të gjitha bisedat tona  
ndihet përplasja e valëve mbi shkëmbenjtë  
e bardhë.

Ka disa ditë që marrin me vete në Vlorë  
fytyra taracash të ngarkuara rëndë...

## PORTIERI I FABRIKES

Tek porta e hekurt e fabrikës,  
në të gjitha stinët që ikin,  
në të gjitha stinët që vijnë,  
do të sjell ndërmend portierin e vjetër,  
të dashur për gjithë punëtorët,  
me kasketën mbi flokët thinjoshe  
dhe buzëqeshjen e bardhë në buzë.

Unë isha punëtori më i ri ahere  
dhe e thërrisja thjesht' me emrin HODO...  
Në pranverë, kur toka shkrinte borën e dimrit,  
ai vinte më herët se ditët e tjera;  
pastronte oborrin e fabrikës  
dhe mbillte në kopështin e vogël lule të kuqe.

Do ta sjell ndërmend pranë portës së hekurt  
në të gjitha stinët që ikin,

në të gjitha stinët që vijnë...  
(Edhe në ditët e nxehta të verës  
kur rrinim tek stoli, poshtë stendës së inisiativave  
dhe lexonim vjershat e mia dhe ai  
qeshte me ngrohtësi, më shpupuriste flokët  
dhe përzihej me ëndrrat e mia!)


Ai rri gjithmonë tek porta e fabrikës  
me «mirmëngjegin» e freskët në buzë...  
Dhe i njeh të gjithë punëtorët,  
edhe më të vjetërit  
edhe më të rinjtë...  
Përherë me gaz u hap portën prej hekuri,  
përherë me gaz u hap portën e dashurisë!

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Prag feste .....	3
Në varret e dëshmorëve .....	5
Pavdekësi .....	6
Për njerëzit dhe malet .....	8
Në Borovë .....	10
Ëndërrime pranverore .....	11
Me barinj të në kullotat verore .....	14
Në këto vise .....	16
Këngë e re për një motiv të vjetër .....	18
Sa për njohje .....	20
Po iki këtë mëngjez vjeshte .....	21
Shqetësim .....	23
Në Gostivisht .....	24
Elegji për Paro Kitan .....	26
Mëngjez në fshat .....	28
Netë të arta .....	30
Një vjershë e shkruar nën shiun e artë .....	31
Tregim për një shok .....	33
Ikën pelikanët .....	35
Në muzeum .....	37
Bashkatdhetarëve të mi të mbetur në Mathauzen .....	38

Në qytetin e vogël buzë liqenit .....	40
E paharruara .....	42
Ky mëngjez lamtumire .....	44
Në lagjen e një qyteti bregdetar .....	46
Rudina .....	47
Ka ardhur vjeshta .....	48
Përsëri në rrugë .....	50
Pashë lopët tek kullosnin .....	52
Pa titull .....	54
Plantacione hallesh .....	56
Solidare .....	57
Diçka për Bajronin .....	59
Poetëve që e quajnë veten «modernë» .....	60
Mbrëmë .....	62
Pejzazh industrial .....	63
Shi në Maj .....	64
Korçës .....	65
Dimër .....	66
Lirika e ditëve të bardha .....	67
Këmbana me tinguj epikë .....	69
Në shërbim .....	71
Një natë pushimi .....	72
Sërish erdha .....	73
Nëpër rrugën e gjelbër .....	75
Portieri i fabrikës .....	76





Redaktor: *Ramazan Vozga*

Piktor: *Musa Qarri*

Tirazhi 1 500 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

---

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974